



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
VENDIM**

Nr _____, date _____

Për

HARTIMIN E PROGRAMIT DHE RRJETIT KOMBËTAR TE MONITORIMIT TË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 41 dhe pikës 2 të nenit 42 të Ligjit Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit" me propozim të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QELLIMI

1. Ky vendim ka për qëllim:
 - a) Të përcaktoj rregullat dhe procedurat për hartimin e programit kombëtar të monitorimit;
 - b) Organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit.

II. PERKUFIZIME

Në këtë vendim termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

- a) "Agjensia", është Agjensia Kombëtare e Mjedisit, agjensitë rajonale të mjedisit;
- b) "Minister" është ministri përgjegjës për mjedisin;
- c) "Ministria" është ministria përgjegjëse për mjedisin;
- ç) "Institucion monitorues" përfshin institutet, qendrat kërkimore, laboratorët brenda universiteteve apo institucioneve shtetërore, ose institutet dhe laboratorët private;
- d) "Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit" (PKMM) është programi periodik i monitorimit të gjendjes së mjedisit në Republikën e Shqipërisë;
- e) "Rrjet" është rrjeti kombëtar i institucioneve të specializuara të monitorimit që marrin pjesë në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit të parashikuar në ligjin për mbrojtjen e mjedisit;
- ë) "Metadata" është baza e të dhënave që përshkruan ose përfshin një grup të dhënash.

III. RRJETI KOMBËTAR I MONITORIMIT

1. Agjensia është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
2. Institucionet anëtare që përfshihen në Rrjet janë::

- Agjensia Kombëtare e Mjedisit – përgjegjëse për monitorimin e
 - Cilësisë së ujërave sipërfaqësore (përjashtuar ujërat për larje)
 - Cilësisë së ajrit
 - Shkarkimeve në ajër nga veprimtaritë industriale
 - Mbetjeve
 - Zhurmave
 - Florës, faunës, biodiversitetit dhe pyjeve
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) – përgjegjës për monitorimin e
 - Cilësisë se ajrit
 - Cilësisë se ujerave për larje
 - Rrezatimit
- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqesore – përgjegjëse për monitorimin e
 - Cilësisë së tokës
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar – përgjegjës për monitorimin e
 - Cilësisë së ujërave nëntokësore

3. Cdo institucion anëtar i Rrjetit emëron një përfaqësues si pikë fokale me qëllim komunikimin dhe bashkëveprimin e ndërsjelltë me Agjensinë.
4. Ministri në çdo kohë ndryshon përbërjen e Rrjetit bazuar në kriteret të përcaktuara.

IV. HARTIMI DHE PERSHTATJA E PROGRAMIT KOMBETAR TE MONITORIMIT TE MJEDISIT (PKMM)

1. Agjensia harton propozimin për PKMM çdo tre vjet.
2. Ministri aprovon PKMM për një periudhë tre vjeçare duke bërë edhe parashikimet e nevojshme në buxhet.
3. PKMM, në përputhje me kërkesat e legjislacionit relevant në fuqi, të përfshij dhe përshkruaj:
 - a) Qëllimin e përgjithshëm;
 - b) Rolin e çdo pjesmarrësi në Rrjet;
 - c) Numrin dhe vendet (gjeo-referenca) e stacioneve te monitorimit;
 - d) Numrin e parametrave që monitorohen dhe frekuencën për çdo stacion monitorimi;
 - e) Llojin e mostrës, metodën e monitorimit, metodën laboratorike, vlerat kufi dhe njësinë e matjes për çdo parametër që monitorohet;
 - f) Procedurën e përpunimit, ruajtjes, njohjes, shkëmbimit dhe prezantimit të të dhënave;
 - g) Buxheti i kërkuar për çdo institucion pjesmarrës në Rrjet.
4. Ministri përshtat PKMM tre vjeçar në varësi të buxhetit në dispozicion.
5. Pas miratimit PKMM publikohet në faqen e internetit të Agjensisë dhe përbën dokument publik në kuptim të ligjit për mbrojtjen e mjedisit.
6. Ministri bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi raporton në Këshillin e Ministrave në lidhje me çështje të rëndësishme të politikave mjedisore që kanë gjetur zgjidhje në apo si rezultat i PKMM.

V. ZBATIMI I PROGRAMIT KOMBETAR TE MONITORIMIT TE MJEDISIT

1. Agjensia është përgjegjëse për zbatimin e PKMM.

2. Agjensia çdo tre muaj organizon takime me institucionet anëtare të Rrjetit për të diskutuar në lidhje me përmirësimin e aktiviteteve të monitorimit dhe koordinimin e zbatimit.
3. Cdo institucion anëtar i Rrjetit dorëzon të dhënat e tij së bashku me raportin vjetor në Agjensia brenda muajit janar të vitit pasardhës. Të dhënat mund të kërkojnë on-line në çdo kohë. Raporti vjetor përmban të dhënat e monitorimit bruto me detaje të sigurta cilësore, përpunimin e të dhënave, metadata dhe interpretime shoqeruese që përfshijnë sqarimet teknike përkatëse.
4. Agjensia mund të kërkojë nga çdo institucion anëtar i Rrjetit të marrë pjesë në studime apo analiza kombëtare që përfshihen në programe të veçanta vjetore të monitorimit të mjedisit për vitin pasardhës, përkundrejt pagesës.
5. Detyrat e Agjensisë janë:
 - a) Mbledhja e të dhënave nga institucionet anëtare të Rrjetit;
 - b) Përgatitja e Raportit Vjetor të Gjendjes së Mjedisit dhe publikimi i tij;
 - c) Hartimi i rekomandimeve për Ministrin në lidhje me vendimet për politikën si rezultat i monitorimit;
 - ç) Hartimi i rekomandimeve për Ministrin për ndryshime të PKMM nëse rezultojnë të nevojshme;
 - d) Shërben si Pike Fokale Kombëtare pranë Agjensisë Europiane të Mjedisit;
 - f) Raporton pranë Agjensisë Europiane të Mjedisit për llogari të Republikës së Shqipërisë.

VI. KONTROLLI

1. Ministri i kërkon Agjensisë të ndërmarrë kontrole në rast të ngjarjeve të ndotjes ose në lidhje me shqetësime të veçanta të politikave mjedisore.
2. Agjensia kërkon nga institucionet anëtare të Rrjetit të ndërmarrin aktivitete monitoruese përkatësisht në lidhje me ngjarjet apo shqetësimet e referuara në pikën 1 të këtij paragrafi.

VII. ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE

1. Ministri është përgjegjës për administrimin e të dhënave të monitorimit të Rrjetit dhe ka të drejtë të kërkojë çertifikimin e të dhënave nëse është i nevojshëm.
2. Agjensia ruan të gjitha të dhënat e monitorimit në një program të dhënash (databazë), në të cilin kanë të drejtë hyrje të gjitha institucionet anëtare të Rrjetit. Ministri përcakton rregullat për hyrjen në programin e të dhënave.
3. Të dhënat mbi gjendjen e mjedisit, por të monitoruara nga institucione të tjera publike ose nga sektorë të rëndësishëm të mjedisit me ndikim në mjedis duhet të vihen në dispozicion të Agjensisë pa shpërblim.
4. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga Agjensia janë publike, të publikuara në faqen e internetit të Agjensisë.

VIII. PERBALLIMI I SHPENZIMEVE

1. Këshilli i Ministrave do të përcaktojë buxhetin vjetor për secilin institucion anëtar të Rrjetit, në përputhje me planifikimin për çdo komponent të PKMM dhe rolin dhe detyrat respektive të tyre në PKMM.
2. Shpenzimet e monitorimit për çdo institucion anëtar të Rrjetit përballohen nga buxheti vjetor i vitit përkatës.

3. Agjensia e përdor buxhetin e saj të monitorimit duke lidhur marrëveshje kontraktuale me institucione të specializuara monitoruese ose duke ndërmarrë monitorime kryesisht.
4. Monitorimet e kontrollit të parashkuara në paragrafin VI do të financohen nga një buxhet i veçantë i parashikuar nga Ministri. Agjensia do të administrojë këtë buxhet për llogari të Ministrisë.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë" shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
2. Ministri është përgjegjës për nxjerrjen e urdhrit që aprovon PKMM.
3. Ministri është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTER

Edi Rama